



**Instituti Demokratik i Kosovës  
Kosova Democratic Institute**

[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

# **PROGRAMET ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE DHE REFLEKTIMI I TYRE NË PUNIMET E KUVENDIT**

## **REFLECTION OF ELECTORAL PARTY PROGRAMS IN THE NATIONAL ASSEMBLY PROCEEDINGS**





## **Personeli**

Ismet KRYEZIU - *Drejtor ekzekutiv*

Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*

Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*

## **Programi - Qeverisja Qendrore**

Valmir ISMAILI - *Menaxher programi*

Fitore ZENELI - *Asistente e programit*

Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*

Isuf ZEJNA - *Monitorues*

Kaltrina ADEMI – *Monitorues*

Rrezarta AHMETI – *Monitorues*

## **Programi - Qeverisja Lokale**

Bleranda ZOGAJ - *Menaxhere programi*

Ramadan KLISURICA – *Monitorues*

## **Programi - Transparenca dhe Antikorrupsioni**

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*

Admir ISTREFI - *Asistent Programi*

Besnik RAMADANAJ - *Zyrtar për mardhënie me publikun*

Sahit BIBAJ - *Avokat / Këshilltar juridik*

Natyra KASUMAJ - *Vullnetare*

Visar RAMAJ- *Vullnetar*

## **Adresa:**

Instituti Demokratik i Kosovës – KDI

Rruga: Rexhep Mala, Nr. 33, Prishtinë

Email: [office@kdi-kosova.org](mailto:office@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

## **Përmbajtja**

1. Hyrje.....	5
2. Përmbledhje ekzekutive.....	6
3. Partia Demokratike e Kosovës – PDK.....	7
4. Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK.....	10
5. Aleanca Kosova e Re – AKR.....	12
6. Lidhja Demokratike e Dardanisë – LDD.....	13
7. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK.....	14
8. Përfundimet.....	15
9. Bibliografia.....	16

## 1. Hyrje

Programi zgjedhor është një nga dokumentet kryesore të secilës parti politike në të cilën shprehen qëndrimet dhe pikëpamjet në lidhje me çështjet më të rëndësishme për elektoratin si siguria kombëtare, arsimi, politikat ambientaliste apo mirëqenia sociale. Përmes këtyre pikëpamjeve dhe qëndrimeve partitë politike synojnë të bindin zgjedhësit dhe të fitojnë besimin e tyre. Çdo parti politike përgatit programin e vet zgjedhor, ndërsa anëtarët e partisë mund të kenë programet e tyre individuale por që janë shumë të përafërta me programin e partisë.

Para mbajtjes së zgjedhjeve programet zgjedhore paraqiten dhe shpërndahen në tërë vendin ndërsa mediat dhe gazetarët kanë rol të rëndësishëm në analizimin e tyre dhe shtjellimin e tyre. Kjo u mundëson zgjedhësve të vlerësojnë programet e partive dhe të vendosin të votojnë për një parti apo kandidat të caktuar. Por, njëkohësisht kjo u mundëson atyre të vlerësojnë shkallën e reflektimit të programeve zgjedhore në programin qeveritar apo në punimet e organit legjislativ.

Gjatë tetë viteve të fundit, partitë politike në Kosovë vazhdimisht janë angazhuar në ndërtimin e profilit të tyre politik dhe ideologjik dhe njëkohësisht kanë iniciuar kontaktet dhe bashkëpunimin me partitë e mëdha evropiane. Sidoqoftë, partitë politike ende mbështeten kryesisht në liderin e partisë dhe më pak në programet partiake. Por, para zgjedhjeve të vitit 2007 partitë politike arritën të zhvillojnë dhe prezantojnë programet zgjedhore të cilat edhe pse si prioritet kishin zgjedhjen e statusit dhe shtet-formimin, një vëmendje të veçantë i kanë kushtuar çështjeve ekonomike, shërbimeve publike dhe mirëqenies sociale.

Megjithatë, në zgjedhje morën pjesë më pak se 40% e elektoratit kryesisht për shkak të humbjes së besimit në institucione, procedurat e komplikuara të votim por edhe motit të ligë. Disa ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) arritën marrëveshje për të formuar koalicionin qeverisës, edhe për faktin se ishin parti rivale për tetë vitet e mëparshme. Marrëveshja e koalicionit u konsiderua si partneritet i dy partive të përkushtuara për ndërtimin e një shteti të pavarur, sovran dhe demokratik. Në anën tjetër Aleanca Kosova e Re (AKR), Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) mbetën partitë më të mëdha të opozitës.

Një hulumtim i zhvilluar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) disa muaj më parë shpallosi një varg çështjesh të cilat konsideroheshin si prioritet për qytetarët e Kosovës. Ky hulumtim u pasua me një analizë krahasuese rreth prioriteteve të qytetarëve dhe përfshirjes së tyre në programet zgjedhore të partive politike para zgjedhjeve të vitit 2007. Në masë të kufizuar kjo analizë bëri edhe disa krahasime rreth reflektimit të programeve zgjedhore të partive në koalicion në programin e qeverisë. Por meqë kjo analizë u zhvillua në fillim të vitit 2008 dhe organet e Kuvendit ende nuk ishin funksionale, matja e shkallës së reflektimit të programeve zgjedhore në punimet e Kuvendit ishte e pamundur.

Andaj, ky hulumtim ka për qëllim të zhvillojë një analizë krahasuese rreth shkallës së reflektimit të programeve zgjedhore të partive politike në punimet e Kuvendit gjatë vitit 2008. Duke marrë parasysh numrin e ulëseve të fituara dhe rëndësinë e tyre në skenën

politike vetëm pesë partitë parlamentare më të mëdha janë përfshirë në këtë hulumtim. Kjo analizë do të shpalos fakte dhe informacione në lidhje me përputhjen e prioriteteve dhe objektivave të programeve zgjedhore të partive në koalicion me strategjinë legjislative dhe çështjet tjera të diskutuara në Kuvend. Ndërsa, pjesa e dytë e analizës do të ketë në fokus përmbajtjen e programeve zgjedhore të partive opozitare dhe reflektimin e tyre në punimet e Kuvendit përmes iniciativave legjislative dhe shfrytëzimit të mekanizmave mbikëqyrës parlamentar. Në fund, bazuar në gjetjet kryesore të këtij hulumtimi do të nxjerrim disa përfundime specifike rreth shkallës dhe cilësisë së reflektimit të programeve zgjedhore të partive në Kuvend.

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Kryesisht me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, partitë politike në Kosovë kanë arritur të zhvillojnë strukturat e tyre organizative dhe kapacitetet për shtrirjen e aktiviteteve tek masat e gjëra të qytetarëve. Madje, para zgjedhjeve të fundit dolën me programe zgjedhore solide që reflektonin në masë të madhe çështje që përmes anketave të ndryshme ishin konsideruar me prioritet për qytetarët. Për dallim nga vitet e mëparshme, programeve zgjedhore të partive politike u është dhënë hapësirë më e madhe në media dhe analizat e tyre kanë ndikuar në rritjen e vetëdijesimit të zgjedhësve për përmbajtjen e tyre. Edhe pse kanë treguar vullnetin politik dhe gatishmërinë për të zhvilluar programet zgjedhore, shumë punë mbetet të bëhet për të siguruar që këto programe do të shndërrohen në politika dhe iniciativa legjislative.

Reflektimi i programeve zgjedhore të partive në punimet e Kuvendit gjatë vitit 2008 ka qenë i limituar në masë të madhe, për faktin se agjenda e Kuvendit ka qenë e dominuar me aktivitete që janë ndërlidhur me zgjidhjen e statusit dhe miratimin e legjislacionit që ndërlidhej me të. Më 17 shkurt Kuvendit miratoi Deklaratën e Pavarësisë që u pasua me miratimin e Kushtetutës në muajin prill. Legjislacioni nga pakoja e Presidentit Ahtisari i shqyrtuar dhe miratuar në Kuvend ka përmbajtur në vete 41 ligje vitale të ndërlidhura me statusin. Përveç kësaj, gjatë vitit 2008 Kuvendi në punimet e tij rishqyrtoi dhe miratoi një pjesë të madhe të grupit të ligjeve të panëshkruara nga PSSP-ja në vitet e mëparshme.

Sidoqoftë, deri në një masë të gjitha partitë arritën të adresojnë objektivat e programeve të tyre zgjedhore në punimet e Kuvendit. Programi qeveritar i cili më pas u reflektua në Kuvend përmes strategjisë legjislative përmban objektiva nga programet e dy partive më të mëdha të koalicionit, megjithëse vërehet një dominim i programit të Partisë Demokratike. Siç edhe pritej, pjesa dërmuese e objektivave të partive në pushtet u adresuan në Ligjin mbi Buxhetin e shtetit. Përmes Ligjit për Buxhet të shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi, partitë në pushtet siguruan alokimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e prioriteteve nga programet e tyre zgjedhore. Partitë në pushtet arritën të adresojnë legjislacionin kyç dhe politikën në lidhje me procesin e shtet ndërtimit, politikën e jashtme, politikën fiskale, zhvillimin ekonomik, arsimin, infrastrukturën rrugore dhe energjinë. Por, politikën dhe legjislacionin që ndërlidhet me sektorin e shëndetësisë, sigurisë, mirëqenies sociale dhe drejtësisë me përjashtim të ligjeve që ndërlidhen me statusin nuk u reflektuan sa duhet në punimet e Kuvendit.

Në anën tjetër, tri partitë më të mëdha opozitare, AKR, LDD dhe AAK gjatë vitit 2008 vazhdimisht kanë kritikuar qeverinë për prioritetet e vendosura në programin qeveritar dhe

implementimin e tyre në praktikë. Gjatë shqyrtimit të legjislacionit, debateve parlamentare dhe veçanërisht përmes mekanizmave mbikëqyrës parlamentar, partitë opozitare kanë drejtuar kritikën e tyre ndaj disa sektorëve. Kritikën më të mëdha janë bërë në lidhje me politikën e jashtme, sektorin e sigurisë dhe integritetin e veriut, sektorin e energjetikës, sektorin e drejtësisë, ndryshimet në politikën fiskale, mos akreditimin e Universiteteve private dhe proceset rreth integritetit në BE. Në shumë raste ata kanë ofruar edhe alternativa për zgjidhjen e problemeve që reflektonin programet e tyre zgjedhore.

Edhe pse janë treguar shumë aktiv në punimet e Kuvendit, grupet parlamentare të partive opozitare nuk kanë ushtruar të drejtën për iniciativë legjislative duke mos hartuar dhe dorëzuar për shqyrtim në Kuvend asnjë projektligj. Gjithashtu, partitë opozitare nuk arritën të bashkohen dhe të formojnë qeverinë në hije, që do të mundësonte që bashkërisht të përgatisin kritikën dhe të ofrojnë alternativat e tyre. Por, duke marrë parasysh se viti 2008 është shënuar me marrjen e vendimeve më të rëndësishme kombëtare ku kërkohet uniteti i faktorit politik dhe me një agjendë të ngjeshur të Kuvendit, deri në një masë performanca e opozitës mund të justifikohen. Në anën tjetër, partitë në pushtet vazhdimisht e kanë konsideruar vitin 2008 si vitin e realizimit të vizionit të partive të tyre dhe inicimin e objektivave kyçe nga programet e tyre zgjedhore.

### 3. Partia Demokratike e Kosovës – PDK

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e hartoj programin e vetë zgjedhor me kohë, por prezantimi i tij u bë në pjesë të ndara dhe asnjëherë nuk u publikua si dokument i tërë. Vështirësitë për të pasur qasje me kohë në të gjitha pjesët e programit zgjedhor shkaktuan probleme në zhvillimin e analizave krahasuese. Si partia më e madhe e dalë nga zgjedhjet, PDK arriti të transferojë një pjesë të madhe të objektivave nga programi zgjedhor në programin qeveritar dhe në punimet e Kuvendit. Në vazhdim do të analizojmë një përmbledhje të përmbajtjes së programit të kësaj partie dhe premtimet kryesore që u reflektuan në punën e Kuvendit.

***Shpallja e Pavarësisë dhe procesi i shtet-ndërtimit*** - Si në programet e të gjitha partive politike edhe PDK në programin e vetë zgjedhor, shpalljen e pavarësisë dhe ndërtimin e shtetit e ka vendosur si prioritet të parë. PDK ka premtuar përshpejtimin e procesit të zgjidhjes së statusit në koordinim me shtetet mike të perëndimit. Ky premtim është përmbushur me faktin se Kuvendi i Kosovës i udhëhequr nga PDK inicioi dhe përbylli me sukses procesin e shpalljes së pavarësisë. Ky premtim parazgjedhor u reflektua në punimet e Kuvendit veçanërisht përmes shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve nga pakaja e Ahtisarit që ndërlihdeshin direkt me zbatimin e marrëveshjes për statusin. Edhe pse shpallja e pavarësisë dhe miratimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore për shtetin e ri është rezultat i angazhimit të tërë spektrit politik në faza të ndryshme, ky premtim specifik nga programi zgjedhor i PDK-së është adresuar plotësisht në punimet e Kuvendit dhe është përmbushur.

***Zhvillimi ekonomik dhe punësimi***- Në programin e saj zgjedhor PDK-ja ka premtuar të zvogëlojë papunësinë përmes zvogëlimit të normave interesit të kredive për kompanitë të cilat kanë kapacitet për zgjerim dhe rritje të numrit të punëtorëve dhe zvogëlimin e taksave me qëllim të tërheqjes së investimeve nga korporatat ndërkombëtare. Përderisa normat e interesit të kredive vazhdojnë të jenë shumë të larta, në dhjetor Qeveria dorëzoi në Kuvend për shqyrtim katër ligje të cilat synojnë ndryshimin e politikave fiskale.

Këto ligje të miratuara nga Kuvendi siguruan zvogëlimin e tatimeve në të hyrat personale dhe taksave për bizneset, përderisa humbjet nga këto ndryshime parashihte ti kompensojë me rritjen e akcizës dhe normës së TVSH-së. Zyrtarët qeveritarë pohonin se këto ndryshime do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e të ardhurave personale dhe njëkohësisht do të zvogëlojnë koston e zhvillimit të bizneseve në Kosovë. Në anën tjetër, procesi i privatizimit që është konsideruar si element i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik gjithashtu është adresuar në Kuvend, përmes shqyrtimit dhe miratimit të Ligjit mbi Agjensionin Kosovar të Privatizimit. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme gjithashtu është reflektim i programit zgjedhor të PDK-së.

Premtimet për ndryshime rrënjësore në zvogëlimin e papunësisë, përmirësimin e kushteve për punëtorët dhe rritjen pagave janë adresuar pjesërisht në Kuvend. Buxheti i planifikuar për vitin 2008 mundësoi rritjen e pagave për mësimdhënësit por premtimet për rritjen e pagave të punonjësve shëndetësor, shërbyesve civil dhe policëve nuk u realizuan. Me gjithë rëndësinë e madhe për përmirësimin e kushteve për punëtorët, Ligji i Punës nuk është hartuar dhe dorëzuar për shqyrtim në Kuvend.

Premtimet për rritjen e pensioneve për 100% janë reflektuar pjesërisht gjatë përgatitjes dhe miratimit të buxhetit për vitin 2008 duke rezultuar me një rritje shumë të vogël të pensioneve. Ligji mbi Pensionet i cili iu premtua pensionistëve gjithashtu nuk është dorëzuar në Kuvend për miratim. Pozita e pensionistëve aktual dhe të ardhshëm është vështirësuar edhe më shumë për faktin se partitë në pushtet dështuan në emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional, nga ana e Kuvendit. Humbjet e trustit në krizën e fundit globale llogaritet të jenë rreth 22%.

**Arsimi**- Në programin e saj zgjedhor PDK ka premtuar kushte më të mira në shkollat fillore dhe të mesme, pajisjen e tyre me kompjuterë, rritjen e kualitetit në institucionet e arsimit të lartë dhe rritjen e pagave për mësimdhënësit. Me 58 milion euro buxhet të alokuara përmes Ligjit për Buxhet që u miratua në Kuvend, Ministria e Arsimit inicoi mbi 70 projekte për renovimin dhe ndërtimin e shkollave fillore dhe të mesme në tërë vendin dhe pajisjen e tyre me kompjuterë. Pagat e mësimdhënësve janë rritur për 25% gjatë vitit 2008 dhe për herë të parë ka filluar zbatimi i sistemit të kategorizimit të pagave në bazë të përgatitjes akademike dhe përvojës. Me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi Ligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore.

Për të rritur kualitetin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, Qeveria nisi procesin e vështirë të vlerësimit dhe akreditimit të universiteteve private. Ministria e Arsimit konsideroi se një numër i madh i institucioneve private të arsimit të lartë të themeluara gjatë administrimit të UNIMK-ut nuk përmbushnin kriteret e parapara në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë. Këshilli Britanik i Akreditimit i angazhuar nga Qeveria për të vlerësuar universitetet private, doli me përfundimin se me përjashtim të Universitetit Amerikan asnjë universitet tjetër privat nuk plotëson kriteret për akreditim dhe nuk lejohet të regjistrojë studentë të ri. Vendimi u kritikua ashpër nga opozita në Kuvend, por pati mbështetjen e plotë të grupeve parlamentare të partive në pushtet. Procesin e akreditimit më pas u pasua me miratimin e Ligjit për Kualifikimet Kombëtare që po ashtu konsiderohet si reflektim i programit zgjedhor të PDK-së.



**Sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale**— Në programin e saj zgjedhor, PDK-ja ka premtuar hartimin dhe miratimin e legjislacionit në lidhje me sigurimet shëndetësore dhe shërbime mjekësore më të lira për të moshuarit dhe pensionistët. Rritja e buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë në 100 milion euro the modernizimi i pajisjeve në spitale ishin po ashtu në mesin e objektivave në programin zgjedhor. Sidoqoftë në programin qeveritar vërehet qartë që sektori i shëndetësisë është lënë në fund të prioriteteve. Është me rëndësi të përmendet fakti se Ministria e Shëndetësisë u drejtua nga partneri në koalicion LDK që përgjatë tërë vitit u përball me vështirësi të mëdha dhe skandale të njëpasnjëshme.

Ligji mbi Sigurimet Shëndetësore nuk u hartua dhe nuk u dorëzua në Kuvend edhe pse parashihej në programin zgjedhor të PDK-së. Premtimet për të garantuar shërbime mjekësore më të lira për të moshuarit dhe pensionistët nuk janë adresuar në formë të iniciativës legjislative. Edhe premtimi për rritjen e buxhetit në 100 milionë eurp nuk u përmbush gjatë vitit 2008 ndërsa edhe për vitin 2009 në Ligjin për Buxhet janë paraparë vetëm 66 milion. Ligji mbi Ndërprerjen e Shtatëzanisë është i vetmi legjislacion substancial që ndërlidhet me sektorin e shëndetësisë që u miratua nga Kuvendi në vitin 2008. Madje edhe ky ligj nuk u nënshkrua nga Presidenti i cili e riktheu në Kuvend për rishqyrtim.

**Zhvillimi i infrastrukturës dhe sektori i energjetikës**- Sa i përket zhvillimit të infrastrukturës, në programin e saj zgjedhor PDK është fokusuar kryesisht në infrastrukturën rrugore. Sidoqoftë, programi ishte i mangët për faktin se nuk ofronte shpjegime rreth mënyrës se si do të mbuloheshin shpenzimet për ndërtimin e autostradave dhe implementimin e projekteve tjera të mëdha. Por ndarjet buxhetore për Ministrinë e Transportit në vitin 2008 të miratuara në Kuvend, i mundësuan qeverisë që gjatë vitit të ndërtojë 600 kilometra rrugë. Madje gjatë rishikimit buxhetor, Kuvendi i miratoi Qeverisë kërkesën për ri-alokim të mjeteve për projektin Morinë-Merdar dhe shfrytëzimin e tyre për ndërtimin e rrugëve të tjera rajonale dhe lokale. Ky ri-alokim u bë kryesisht për shkak të vështirësive me shpronësim në zonat ku parashihet të kalojë autostrada. Ndërsa për vitin 2009, me miratimin e Ligjit për Buxhet, Qeveria e drejtuar nga PDK ndau 115 milion për Ministrinë e Transportit.

Hartimi dhe më pas miratimi nga Kuvendi i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Rrugët gjithashtu reflekton programin zgjedhor të PDK-së. Ndërsa për të siguruar shpronësimin efikas në zonave ku do të kalojnë rrugët që parashihet të ndërtohen, Qeveria dorëzoi Ligjin për Shpronësim i cili për shkak të afateve kohore nuk arriti të miratohej nga Kuvendi gjatë vitit 2008. Edhe infrastruktura ligjore për hekurudhat dhe aviacionin civil e paraparë në programin e partisë dhe veçanërisht në programin qeveritar u plotësua me miratimin e Ligjit mbi Hekurudhat dhe Ligjin mbi Aviacionin Civil.

Në programin e vetë zgjedhor, PDK-ja ka shprehur vendosmërinë për të përmirësuar infrastrukturën e KEK-ut ndërsa tërë fushatën e karakterizoi slogani “24 orë rrymë”. Ata premtuan edhe investime në mbi 90 milion euro ne rivitalizimin e minierave ekzistues dhe ndërtimin e një transmetuesi të energjisë për tu lidhur me sistemin energjetik të Shqipërisë, por që shumë pak janë reflektuar në Kuvend në formë te legjislacionit. Çështjet e sektorit të energjetikës në Kuvend janë adresuar kryesisht përmes Ligjit për Buxhet ku janë miratuar subvencione për importim të rrymën prej 44 milion eurove për vitin 2008 dhe mbi 62 milion eurove për vitin 2009.

Gjatë fushatës parazgjedhore PDK-ja vazhdimisht ka kritikuar qeverinë e mëparshme për shkak të planeve për privatizimin e KEK-ut. Por me ardhjen në pushtet ata filluan procedurat për privatizimin e Sektorit të Distribuimit të KEK-ut dhe iniciuan procedurat e miratimit në Kuvend. Plani për privatizimin e këtij sektori është miratuar nga komisioni funksional parlamentar ndërsa pritet të miratohet nga Kuvendi në fillim të vitit 2009. Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës në sektorin e energjetikës, qeveria hartoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë i cili më pas u miratua në Kuvend.

**Sundimi i ligjit dhe Masat kundër korrupsionit** – Sundimi i ligjit u rendit në mesin e prioriteteve në programin zgjedhor të PDK-së. Hartimi i legjislacionit të ri, harmonizimi i legjislacioni ekzistues, krijimi i një sistemi efikas të drejtësisë dhe ndërtimi i kapaciteteve në institucione korrektuese ishin disa nga premtimet kryesore. Kompetencat për çështjet që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit i takojnë Ministrisë së Brendshme të drejtuar nga PDK dhe Ministrisë së Drejtësisë të drejtuar nga LDK, të cilat gjatë vitit janë përballur me procesin e transferimit të kompetencave nga UNMIK-u dhe konsolidimin e plotë. Në të dy këta sektorë ka pasur ngecje që vazhdimisht janë theksuar nga grupet parlamentare opozitare. Lufta kundër korrupsionit përveç që është përfshirë në programin zgjedhor të PDK-së është adresuar në programin qeveritar me premtimet për të mbështetur aktivitetet që ndërlihen me luftën kundër korrupsionit.

Sidoqoftë, vetëm në fund të vitit 2008 Qeveria arriti të përgatis strategjinë e re kundër korrupsionit 2009-20011 e cila u dorëzua për shqyrtim dhe pritet të Kuvendi në fillim të vitit 2009. Gjatë vitit 2008 Qeveria dhe Kuvendi të drejtuar nga PDK dështuan në hartimin dhe miratimin e ligjeve si: Ligji për Financimin e Partive Politike, për pastrimin e parave, sistemin bankar, konfliktin e interesit, konkurrencën ekonomike apo mbrojtjen e dëshmitarëve të cilat konsiderohen me rëndësi vitale në luftën kundër korrupsionit. Sidoqoftë si shenjë pozitive në këtë drejtim në buxhetin për vitin 2009 Kuvendi vendosi të rrisë buxhetin për Agjensionin Anti-Korrupsion si institucion i pavarur. Përveç kësaj, në planin strategjik të miratuar së fundi Kuvendi ka paraparë të themelojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

## 4. Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK

Gjatë fushatës zgjedhore, LDK-ja prezantoi një program solid të bazuar në vizionin e presidentit historik Ibrahim Rugova për një shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Prioritet e LDK-së në programin zgjedhor ishin shpallja e pavarësisë dhe ndërtimi i shtetit, sundimi i ligjit, reformat në sistemin e drejtësisë, shërbim policor efikas, krijimi i forcës së sigurisë, përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe krijimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore. Nga rezultatet e zgjedhjeve LDK-ja doli si partia e dytë më e madhe dhe pranoi ofertën PDK-së për formimin e koalicionit qeverisës. Si partia e dytë më e madhe LDK ka arritur të përshijë një numër të konsiderueshëm të objektivave të programit zgjedhor në programin e qeverisë.

Sidoqoftë, objektivat të programit parazgjedhor nuk janë reflektuar sa duhet në punimet e Kuvendit. Çështjet të cilat kanë qenë kompetencë e ministrive të cilët i takuan LDK-së në bazë të marrëveshjes për koalicion ishin ndër më të vështirat për tu menaxhuar dhe ato nuk ishin në mesin e prioriteteve kryesore të Qeverisë. Sektori i shëndetësisë i udhëhequr nga

LDK ka qenë kaotik gjatë viteve të fundit ndërsa në vitin 2008 vetëm një ligj që ndërlidhet me shëndetësinë, ai mbi Ndërprerjen e Shtatëzanisë ishte shqyrtuar dhe miratuar në Kuvend. Në programin zgjedhor, LDK-ja ka paraparë rritje të buxhetit për sektorin e shëndetësisë për të zhvilluar reforma rrënjësore në shëndetësi dhe për të rritur efikasitetin në shërbime farmaceutike. Megjithatë këto objektiva nuk u realizuan për faktin se në këtë sektor nuk pati rritje të madhe të buxhetit as në vitin 2008 por nuk do të ketë as në vitin 2009. Edhe Ligji për Sigurimet Shëndetësore si prioritet i LDK-së në programin zgjedhor nuk është hartuar dhe dorëzuar për miratim në Kuvend.

Sistemi gjyqësor vazhdoi të përballet me vështirësi të mëdha gjatë vitit 2008, ndërsa në disa raste shërbyesit civil në institucionet e drejtësisë protestuan duke hyrë në grevë. Planet për reforma të thella në drejtësi të premtuara nga LDK-ja, që edhe udhëheq me këtë Ministri nuk u realizuan. Megjithatë, programi i tyre u reflektua në Kuvend përmes një numri të ligjeve të hartuara dhe dorëzuara për miratim me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore. Ligji për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Ligji për procedurën kontestimore, Ligji për procedurën jokontestimore dhe Ligji për Noterinë u shqyrtuan dhe miratuan në Kuvend gjatë vitit 2008.

Në programin e vet zgjedhor LDK premtoi rritje të eksportit të mallrave nga Kosova duke ofruar mbështetje për kompanitë me kapacitet për eksport dhe sigurimin e kornizës legislative për konkurrencë të drejtë. Por, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit ishte i vetmi ligj nën juridiksionin e Ministrisë së Tregtisë të udhëhequr nga LDK që u miratua në Kuvend.

Politika e Jashtme si kapitull i veçantë në programin zgjedhor të LDK-së është reflektuar pothuajse plotësisht në programin qeveritar. Premtimet për shpalljen e pavarësisë dhe njohjen ndërkombëtare, themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, hapjen e ambasadave, themelimin e shërbimit diplomatik dhe anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare janë reflektuar dukshëm në punimet e Kuvendit. Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik si pjesë e ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit u dorëzua për shqyrtim dhe më pas u miratua nga Kuvendi. Gjithashtu, Kuvendi ratifikoi listën e diplomatëve të parë të Kosovës dhe hapjen e 10 ambasadave gjatë vitit 2008. Për themelimin dhe funksionimin efikas të ambasadave të Kosovës në vendet e perëndimit, Kuvendi miratoi 22 milionë euro për Ministrinë e Punëve të Jashtme për vitin 2009.

Përmirësimi infrastrukturës ligjore në sektorin e bujqësisë dhe kushtet e bujqve në përgjithësi ishin renditur ndër prioritet e programit zgjedhor të LDK-së. Këto premtime u adresuan në Kuvend me shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve, Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Kooperativat e Bujqve dhe Ligjit për Inspektionin Bujqësor.

Programi zgjedhor i LDK-së ka paraparë ndërtimin e autostradës Merdar-Morinë si dhe zgjerimin e rrugëve magjistrale në dalje nga Prishtina në drejtimin e Pejës, Mitrovicës dhe Kaçanikut. Të gjitha këto projekte janë përfshirë në programin e qeverisë dhe janë inicuar gjatë vitit 2008, ndërsa implikimet buxhetore janë aprovuar nga Kuvendi në buxhetin vjetor.

Progresi drejt integritimeve Evropiane ishte ndër prioritetet kryesore në programin zgjedhor të LDK-së. Kjo u reflektua veçanërisht në punimet e Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të udhëhequr nga njëri prej liderëve të LDK-së dhe nga Komisioni për Integritime Evropiane. Shumë vizita jashtë vendit dhe monitorimi i vazhdueshëm i progresit të qeverisë në çështjet me interes për integritet evropiane dominuan agjendën e këtyre komisioneve. Në mesin e premtimeve të tjera, LDK-ja nuk arriti të iniciojë reformat në administratën shtetërore dhe të zvogëlojë numrin e shërbyesve civil, kur dihet se numri i shërbyesve civil për vitin 2009 do të rritet edhe në ministritë e drejtuara nga LDK-ja.

## 5. Aleanca Kosova e Re – AKR

Si parti politike e re, zgjedhjet e vitit 2007 ishin të parat për AKR-në. AKR arriti që gjatë fushatës parazgjedhore të organizojë dhe implementojë një fushatë masive bazuar kryesisht tek karizma e liderit të partisë si dhe programi zgjedhor prej 34 faqesh. AKR arriti të bind një numër të madh të zgjedhësve dhe fitoi 13 ulëse në Kuvend. Meqenëse pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve AKR nënshkroi marrëveshje koalicioni me PDK në nivel lokal në disa komuna gjasat ishin të mëdha që të përfshihej në koalicion edhe në nivel qendror. Por, meqë mbetën si partia më e madhe opozitare, programi i tyre qeveritar u reflektuar në punimet e Kuvendit në formë të kritikave të vazhdueshme për politikën qeveritare.

Shtyllat kryesore të programit zgjedhor të AKR-së kanë qenë zhvillimi ekonomik dhe ndryshimi i strukturës së brendshme të Qeverisë. Me qëllim të shmangies së burokracisë dhe mos efikasitetit në institucionet shtetërore, AKR-ja pat planifikuar të bashkonte ministritë e Qeverisë në katër departamente kryesore: Departamenti për Ekonomi, Departamenti për Arsim, Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë dhe Departamenti për Punë dhe Shërbime Publike.

Gjatë shqyrtimi të legjislacionit dhe politikave në komisione dhe në seancat plenare, por veçanërisht përmes pyetjeve parlamentare deputetët e AKR-së kritikuan qeverinë dhe ofruar alternative për çështjet që ndërlidheshin me zhvillimin ekonomik. AKR-ja u ngrit kundër politikave të reja fiskale të propozuara nga Qeveria me theks të veçantë rritjen e TVSH-së, akuzoi Qeverinë për dështimin në tërheqjen e investimeve të jashtme dhe procesin e privatizimit, çështje këto që ishin ndër prioritetet kryesore në programin zgjedhor të AKR-së.

Siç parashihnin në programin e tyre zgjedhor, AKR si alternativë ka shpalosur planin për ndërtimin e termocentraleve me “gaz të gjelbërt” dhe me kapacitet jo më të lartë se 700 MW si zgjidhje afatgjatë. Deputetët e AKR-së ishin shumë të kritikues sidomos ndaj prioritetëve dhe mënyrës së menaxhimit në sektorin e energjetikës. Menaxhimi i dobët i minierave dhe KEK ut ishin ndër çështjet e adresuara nga AKR në Kuvend. Prioritetet e Qeverisë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore gjithashtu ishin kritikuar ashpër, ndërsa ndërtimi i rrugës Gjakovë-Shkodër i paraparë në programin zgjedhor të AKR-së nuk është përfshirë në planet e Qeverisë.

Planet dhe prioritetet e AKR në lidhje me sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale u reflektuan dukshëm në punimet e Kuvendit. Gjatë debateve dhe kohës për pyetje parlamentare, deputetët e AKR-së theksuan shumë herë gjendjen e rëndë në sektorin e shëndetësisë, aferat korruptive, nevojën imediate për legjislacionin që ndërlidhet me

sigurimet shëndetësore, pensionet e vogla, nevojën për ristrukturimin e skemës pensionale, etj.

Politika e jashtme si kapitull i veçantë i programit zgjedhor të AKR-së u reflektua në masë të madhe në punimet e Kuvendit. Përmes pyetjeve parlamentare dhe një interpelance, AKR-ja ka kritikuar Qeverinë për pasivitet në procesin e lobimit për njohjen e pavarësisë. Dështimi për ndërtimin e një Ministrie të Punëve të Jashtme efikase ishte po ashtu ndër kritikën e AKR-së. Kritikën e kësaj partie vazhdimisht shoqëroheshin me alternativë konkrete për ngritjen e kapaciteteve për lobim me qëllim të rritjes së njohjeve për shtetin e ri si dhe anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare.

Edhe pse në programin zgjedhor kanë ofruar plane dhe programe për bujqësinë dhe pylltarinë, çështjet ambientaliste dhe çështjet kulturore dhe sportive, reflektimi i tyre në punimet e Kuvendit ishte i zbehtë. Përndryshe, edhe pse ishin mjaft aktiv, grupi parlamentar opozitar, AKR nuk arriti të hartojë apo dorëzojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend asnjë projektligj.

## 6. Lidhja Demokratike e Dardanisë – LDD

Në programin e saj zgjedhor, LDD deklarohet si parti mes qendrës dhe krahut të djathtë e ndërtuar mbi parimet dhe filozofinë politike të presidentit Rugova. Në zgjedhjet e vitit 2007, LDD si subjekt i ri politik fitoi 11 ulëse në Kuvend. Programi i saj zgjedhor përfshinte në vete edhe Partinë Shqiptare Demokristiane (PSHDK) si partner në koalicion parazgjedhor. Programi zgjedhor përshkruante qartë gjendjen në sektorët kryesorë dhe ofronte alternative për më shumë efikasitet në Qeverinë Qendrore dhe lokale, Zhvillimin Ekonomik, Arsimin dhe Shkencën, Institucionet Shëndetësore, Politikën e Jashtme, Sektorin e Sigurisë, Integritet Evropian, Planifikimin Hapësinor si dhe Kulturën, Rininë dhe Sportin.

Si parti opozitare programi zgjedhor i LDD-së është reflektuar në punimet e Kuvendit kryesisht në kritikën e vazhdueshme të drejtuar ndaj Qeverisë dhe alternativave të ofruara në bazë të programit. Meqenëse programi zgjedhor i LDD-së ka qenë shumë gjithëpërfshirës ishte vështirë të identifikoheshin elemente specifike që u reflektuan në punimet e Kuvendit. Sidoqoftë, gjatë shqyrtimit të ligjeve, kohës për pyetje parlamentare, një interpelance dhe debateve të tjera, grupi parlamentar i LDD ishte mjaft aktiv. Të fokusuar kryesisht në çështjet që ndërlidheshin me statusin, zhvillimin ekonomik, procesin e privatizimit, ndarjet buxhetore, gjendjen e rëndë në sektorin shëndetësor dhe situatën e sigurisë, deputetët e LDD-së kanë kërkuar llogari nga Qeveria dhe kanë ofruar alternativa për zgjidhjen e problemeve.

Grupi parlamentar i LDD-së vazhdimisht ka kritikuar Qeverinë për masa joadekuate për tërheqjen e investimeve të huaja, dështimet në procesin e privatizimit, mungesën e transparencës dhe keq menaxhimin e financave publike. Objektivat e programit të tyre zgjedhor në fushën e sigurisë gjithashtu u ofruan si alternative përderisa akuzonin Qeverinë se ka dështuar të forcojë rolin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, zgjerimin e autoritetit në veri dhe zgjedhjen e udhëheqësve të Forcës së Sigurisë dhe Agjencionit të Inteligjencës.

Pjesa e programit zgjedhor që shtjellonte çështjet e sektorit të shëndetësisë u reflektua në masë të madhe në Kuvend, kryesisht përmes interpelancës parlamentare me Ministrin e

Shëndetësisë të sponsorizuar nga LDD. Gjatë interpelancës, deputetët e LDD-së arritën të shpalosin dështimet e mëdha në sektorin e sigurisë dhe si alternativa kërkuan reformimin dhe decentralizimin e sektorit të shëndetësisë, ndryshimin e formës së financimit për institucionet shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore falas për të moshuarit. Përndryshe, edhe pse ishte mjaft aktiv, njëjtë si grupet tjera parlamentare, grupi i LDD-së nuk arriti të hartojë apo dorëzojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend asnjë projektligj.

## 7. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK

Për zgjedhjet e vitit 2007 AAK-ja hartoi dhe prezantoi një program zgjedhor solid, të detajuar dhe të përmbledhur në 60 faqe. Programi përbëhej nga katër kapituj kryesor: a)Ndërtimi i shtetit, rendi dhe ligjit, b) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, c)Arsimi, shëndetësia dhe mirëqenia sociale dhe d)Infrastruktura, bujqësia dhe mbrojtja e ambientit. Edhe në mungesë të liderit të partisë, AAK arriti të fitojë 11 ulëse në Kuvend por ashtu siç edhe pritej mbeti në opozitë. Duke marrë parasysh faktin se ishin në pushtet gjatë katër viteve, shumica e deputetëve të AAK-së kishin përvojë të gjatë si ministra dhe në përgjithësi kishin informacione rreth zhvillimeve dhe vështirësive në të gjithë sektorët.

Grupi parlamentar i AAK-së ishte mjaft aktiv në Kuvend gjatë shqyrtimit të ligjeve dhe debateve parlamentare ndërsa vazhdimisht ka kritikuar qeverinë për prioritetet dhe politikat saj të zbatuara gjatë vitit 2008. Shpallja e pavarësisë, miratimi i kushtetutës, miratimi i ligjeve që ndërlidheshin me statusin dhe njohja e shtetit të ri ishin prioritetet kryesore të AAK-së në programin zgjedhor. Në punimet e Kuvendit kur këto çështje janë adresuar, AAK-ja vazhdimisht ka akuzuar qeverinë se është munduar të përvetësojë këtë proces dhe se ka dështuar në ndërtimin e një Ministrie efikase për Punë të Jashtme.

Siguria është sektor tjetër nga programi zgjedhor i AAK-së që në masë të madhe u reflektua në punimet e Kuvendit kryesisht në formë të kritikave për qeverinë. AAK-ja vazhdimisht kritikoi qeverinë për vonesa dhe dështime në themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes, krijimin e Forcës së Sigurisë, Agjencionit të Inteligjencës dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë. Në lidhje me proceset e integritimit në BE, AAK-ja ka kritikuar ashpër Qeverinë për mos vazhdimin e iniciativave të qeverisë së mëparshme të udhëhequr nga AAK, veçanërisht në përmbushjen e standardeve që ndërlidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit. Në lidhje me këtë çështje AAK sponsorizoi edhe një interpelancë parlamentare në lidhje me raportin e fundit të progresit të Komisionit Evropian në të cilin u shpalosën shumë parregullsi dhe dështime të Qeverisë.

Domosdoshmëria e reformimit të sistemit të drejtësisë, kompletimi i infrastrukturës ligjore, themelimi i sistemit të noterisë dhe rritja e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët ishin disa nga prioritetet e AAK-së që u reflektuan në punimet e Kuvendit. Ata vazhdimisht kritikuan Qeverinë për mos adresimin e këtyre çështjeve dhe dështimin total në rritjen e efikasitetit të punës në sistemin e drejtësisë. Ndërsa, siç edhe parashihej në programin zgjedhor të saj, AAK mbështeti procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe zvogëlimin e taksave për stimulimin e zhvillimit ekonomik në Kosovë. Megjithatë, AAK kundërshtoi fuqishëm rritjen e TVSH-së dhe akcizës dhe demantoi deklaratat e Qeverisë për gjoja rritjen ekonomike të vendit gjatë vitit 2008.

Përmes programit zgjedhor, AAK ka premtuar përmirësimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe bujqësisë. Andaj, kritikak e saj ndaj Qeverisë për dështimet në reformimin e sistemit arsimor dhe procesin e akreditimit të universiteteve private, në zhvillimin e legjislacionin për sigurimet shëndetësore dhe mungesës së subvencioneve për bujqit u theksuan vazhdimisht. Me gjithë përvojën e gjatë të deputetëve të grupit parlamentar ashtu si edhe partitë tjera opozitare, AAK nuk arriti të hartojë apo dorëzojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend asnjë projektligj. Por, në disa raste ata përmendën faktin se një pjesë e madhe e ligjeve të rikthyera dhe të miratuara gjatë vitit 2008, kanë qenë të përgatitur nga qeveria e mëparshme e udhëhequr nga AAK.

## 8. Përfundimet

Në bazë të gjetjeve kryesore nga kjo analizë krahasuese këto përfundime kryesore mund të arrihen:

- Reflektimi i programeve zgjedhore të partive në punimet e Kuvendit gjatë vitit 2008 ka qenë i limituar në masë të madhe, për faktin se agjenda e Kuvendit ka qenë e dominuar me aktivitete që ndërlidheshin me zgjedhjen e statusit dhe miratimin e legjislacionit që ndërlidhej me statusin;
- Partitë në pushtet arritën të adresojnë legjislacionin kryesor dhe politikak në lidhje me procesin e shtet ndërtimit, politikën e jashtme, politikak fiskale, zhvillimin e ekonomik, arsimin, infrastrukturën rrugore dhe energjinë. Por, politikak dhe legjislacioni që ndërlidhet me sektorin e shëndetësisë, sigurisë, mirëqenies sociale dhe drejtësisë me përjashtim të ligjeve që ndërlidhen me statusin nuk u reflektuan sa duhet në punimet e Kuvendit;
- Gjatë shqyrtimit të legjislacionit, debateve parlamentare dhe veçanërisht përmes mekanizmave mbikëqyrës parlamentar, partitë opozitare kanë drejtuar kritikak e tyre ndaj disa sektorëve;
- Kritikak më të mëdha janë bërë në lidhje me politikën e jashtme, sektorin e sigurisë dhe integrimin e veriut, sektorin e energjetikës, sektorin e drejtësisë, ndryshimet në politikak fiskale, mos akreditimin e universiteteve private dhe proceset rreth integrimit në BE;
- Edhe pse janë treguar shumë aktiv në punimet e Kuvendit, grupet parlamentare të partive opozitare nuk kanë ushtruar të drejtën për iniciativë legjislative duke mos hartuar dhe dorëzuar për shqyrtim në Kuvend asnjë projektligj;
- Partitë opozitare nuk arritën të bashkohen dhe të formojnë qeverinë në hije, që do tu mundësonte që bashkërisht të përgatisin kritikak dhe të ofrojnë alternativat e tyre.

## 9. Bibliografia

AAK. Me Ramushin Kryeministër do ta bëjmë - AAK, Programi Zgjedhor. Prishtinë, 2007.

AKR. Program Zgjedhor 2007- Aleanca Kosova e Re, Prishtinë, 2007.

KDI. Komunikimi dhe Përfshirja e Qytetarëve në Politikat Programore, KDI, Prishtinë, 2008.

LDD. Program i LDD-së për Shtetin e Pavarur të Kosovës- Pavarësi, Paqe, Prosperitet, Prishtinë, 2007.

LDK. Programi për Zgjedhjet Nacionale 2007 – LDK, Prishtinë, 2007.

PDK. Programi Zgjedhor 2007 – PDK. <http://www.krenohu.com>, [www.pdk-ks.org](http://www.pdk-ks.org)

Procesverbalet dhe transkriptet e nxjerra nga faqja elektronike zyrtare e Kuvendit të Kosovës, [www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)





**Instituti Demokratik i Kosovës  
Kosova Democratic Institute**

[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

# **PROGRAMET ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE DHE REFLEKTIMI I TYRE NË PUNIMET E KUVENDIT**

## **REFLECTION OF ELECTORAL PARTY PROGRAMS IN THE NATIONAL ASSEMBLY PROCEEDINGS**





## **Personnel**

Ismet KRYEZIU - *Executive Director*

Vjollca VOGËL - *Admin & Finance Manager*

Leonora CIKAJ - *Admin & Finance Assistant*

## **Program - Central Governance**

Valmir ISMAILI - *Program Manager*

Fitore ZENELI - *Program Assistant*

Driton SELMANAJ - *Program Assistant*

Isuf ZEJNA - *Monitor*

Kaltrina ADEMI – *Monitor*

Rrezarta AHMETI – *Monitor*

## **Program - Local Governance**

Bleranda ZOGAJ - *Program Manager*

Ramadan KLISURICA – *Monitor*

## **Transparency and Anticorruption Program**

Merita MUSTAFA - *Program Manager*

Admir ISTREFI - *Program Assistant*

Besnik RAMADANAJ - *Public Relation Officer*

Sahit BIBAJ - *Lawyer/Legal Advisor*

Natyra KASUMAJ - *Volunteer*

Visar RAMAJ- *Volunteer*

## **Adress:**

Kosova Democratic Institute – KDI

Street: Rexhep Mala, Nr. 33, Prishtinë

